

TLAS



RAPORT VLERËSIMI PËR PROBLEMET QË DALIN NGA MOS REGJISTRIMI I LINDJEVE TË FËMIJËVE ROM

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë



Falenderojmë UNICEF
për mbështetjen financiare të këtij botimi

unicef 
1946 - 2006 

RAPORT VLERËSIMI PËR PROBLEMET QË DALIN NGA MOS REGJISTRIMI I LINDJEVE TË FËMIJËVE ROM

1. Hyrje

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) ka nisur aktivitetin në janar të vitit 1999. Misioni i TLAS ka qënë dhe është ofrimi i shërbimit ligjor falas për individë dhe grupe në nevojë, sensibilizimi i shoqërisë shqiptare mbi shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut, si dhe nxitja e përmirësimeve në sistemin ligjor. TLAS ofron disa shërbime të plota ligjore vetëm për çështjet e së drejtës civile, administrative, familjare, të punës si dhe raste të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Grupet e synuara të TLAS janë individë ose grupe në nevojë si:

- të papunët dhe ata që jetojnë vetëm me ndihmë ekonomike, jetimët dhe të moshuarit pa ose me të ardhura të pamjaftueshme, të paaftët për punë dhe invalidët, pensionistët pa të ardhura të tjera shtesë, familjet e mëdha në numër me të ardhura të pamjaftueshme

Në kuadrin e projektit të Unicef, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), krahas realizimit të regjistrimit të lindjeve të fëmijëve nëpërmjet

procesit gjyqësor, realizoi edhe një vëzhgim, kryesisht me pjestarë të këtyre komuniteteve për të zbuluar më shumë realitetet e tyre, shkaqet e dukurisë së mos regjistrimit dhe nevojave të tyre për të ardhmen.

Vazhdon ende të ketë një numur të madh fëmijësh të paregjistruar në rradhët e minoritetit rom dhe në zonat informale të banimit, të populluara vitet e fundit kryesisht nga familje të shpërngulura. Në këto familje, për një sërë arsyesh, ka ende shumë fëmijë të paregjistruar në regjistrat e gjëndjes civile. Duke u bazuar edhe në këtë realitet, TLAS, me mbështetjen e Unicef ka propozuar që prej dy vjetësh një amendament të Ligjit të Gjëndjes Civile, që do ta zhdukë përfundimisht këtë dukuri të dëmshme jo vetëm për fëmijët dhe familjet e tyre, por edhe për shtetin shqiptar.

Për realizimin e këtij vëzhgimi u intervistuan 170 persona, kryesisht nga minoriteti rom, të cilët plotësuan pyetsorët e përgatitur nga TLAS.

2. Qëllimi i vëzhgimit

Qëllimi i vëzhgimit është krijimi i nje tabloje më të qartë për arsyet e mosregjistrimit të fëmijëve në regjistrat e gjëndjes civile, për shkaqet social ekonomike të kësaj duku-

rie dhe për pasojat direkte në të drejtat e fëmijëve të këtij komuniteti, për krijimin e kushteve normale të jetesës së tyre.

Nga ana tjetër, në kuadrin e përgatitjes nga ana e TLAS, të ligjit për Ndihmën Ligjore Falas në Shqipëri, me anën e këtij vëzhgimi donim të krijojmë një tablo më të qartë të kushteve të jetesës dhe nevojave të minoritetit rom, si një nga grupet kryesore të synuara nga ligji i ri, duke siguruar në të ardhmen një akses real në drejtësi të këtij komuniteti.

3. Procesi i vlerësimit

Procesi i vlerësimit kaloi në disa faza:

- Përgatitja e pyetorit, në përputhje me qëllimin e shprehur më sipër;
- Trajnimi i intervistuesve në lidhje me mënyrën e kryerjes së intervistës dhe plotësimin e pyetsorëve;
- Analiza statistikore e të dhënave të nxjerra nga pyetsorët;
- Nxjerrja e përfundimeve.

4. Metodika

Intervistimi u realizua me:

- 146 persona, pjestarë të

familjeve romë;


- 24 persona, pjestarë të familjeve të shpërngulura në qytetin e Tiranës dhe në bashkitë e komunat e rrethit të Tiranës.
- Intervistimi u krye kryesisht në mjediset e zyrave të TLAS, si dhe në komunitetet ku jetonin këto familje.

4.1 Studimi i të dhënave të të intervistuarve


Grupi i të intervistuarve përbëhet nga grupime të ndryshme të këtij komuniteti, për të marrë perceptimet e ndryshme, në plotësimin e qëllimit të vëzhgimit. Grupi i të intervistuarve ishte i përbërë prej 170 personash.

Karakteristikat social demografike të grupit të të intervistuarve pasqyrohen në tabelat e mëposhtëme dhe përfshijnë: shpërndarjen gjeografike, etninë, gjininë, moshën, gjendjen civile, numrin e personave në familje, numrin e fëmijëve në familje, nivelin arsimor dhe punësimin.


Shpërndarja Gjeografike	Frekuenca	Përqindja
Qyteti Tiranë	91	53,5%
Rrethi Tiranë	17	10%
Rrethe të tjera	62	36,5%
Gjithsej	170	100.0




Etnia	Frekuenca	Përqindja
Romë dhe Egjiptianë	146	85,9%
Maxhoranca	24	14,1%
Gjithsej	170	100.0



Gjinia	Frekuenca	Përqindja
Femra	129	75,9%
Meshkuj	41	24,1%
Gjithsej	170	100.0




Mosha	Frekuenca	Përqindja
18 - 29 vjeç	65	37,6%
30 - 39 vjeç	52	30,6%
40 - 49 vjeç	28	16,5%
50 - 59 vjeç	17	10%
Mbi 60 vjeç	9	5,3%
Gjithsej	170	100.0




Gjendja civile

Beqar	95	55,9%
I/E martuar	54	31,8%
I/E Shkurorëzuar	20	11,8%
I/E ve	1	0,6%
Gjithsej	170	100.0




Numri i fëmijëve në familje

1 fëmijë	23	13,5%
2 fëmijë	49	28,8%
3 fëmijë	53	31,2%
4 fëmijë	34	20%
5 fëmijë	8	4,7%
Mbi 5 fëmijë	3	1,8%
Gjithsej	170	100.0




Numri i personave në familje

2 persona	2	1,2%
3 persona	19	11,2%
4 persona	44	25,9%
5 persona	66	38,8%
mbi 5 persona	39	22,9%
Gjithsej	170	100.0




Niveli arsimor

Analfabet	96	56,5%
1 - 4 klasë	54	31,8%
5 - 8 klasë	15	8,8%
9 - 12 klasë	5	2,9%
Gjithsej	170	100.0



Punësimi		
I/E papunë	74	43,5%
Kërkon në plehra	44	25,9%
I/E vetpunësuar	27	15,9%
Lyp	22	12,9%
I/E punësuar	3	1,8%
Gjithsej	170	100.0



Nga studimi i të dhënave social ekonomike, vërejmë që shumica e të intervistuarve (53,5%) janë nga qyteti i Tiranës. Të tjerët janë nga rrethe të tjera (36,5%), si Fushë Kruja, Elbasani dhe 10% janë nga bashkitë e komunat e rrethit Tiranë, kryesisht Kamëz, Zall Herr, Vaqarr, Kashar, etj. Shumica, 85,9%, është nga minoriteti rom dhe komuniteti egjiptian. Femrat përbëjnë 75,9%, krahasuar me meshkujt 24,1%.

Shpërndarja sipas gjendjes civile tregon që shumica 55,9% janë beqarë, kundrejt 31,8% që janë të martuar dhe 11,8% të shkurorëzuar. Kjo shpërndarje vjen për shkak të një veçorie të familjeve romë, ku nënat kryesisht bashkëjetojnë me baballarët natyrorë të fëmijëve të tyre dhe për këtë arsye vetëm ato mund të kërkojnë në gjykatë regjistrimin e fëmijës.

Shpërndarja sipas moshës tregon se shumica e tyre janë të rinj, ku 37,6% janë të moshës 18-29 vjeç, të ndjekur nga 30,6% të moshës 30-39 vjeç. Në moshat më të rritura përfshihen të intervistuarit që kanë regjistruar fëmijët e tyre madhorë, apo gjyshërit e fëmijëve.

Vërejmë që numri më i madh i familjeve të të intervistuarve (38,8%) përbëhet nga 5 persona, i ndjekur nga familjet me 5 persona, 24,9% dhe ato me mbi 5 persona, 22,9%. Familjet me 3 fëmijë janë shumica (53%). Ato me 2 fëmijë përbëjnë 49% dhe ato me 4 fëmijë, 34%. Pra mbizotërojnë familjet me më shumë se 1 fëmijë.


Niveli arsimor është i ulët. Mbizotërojnë personat analfabetë, 56,5%. 31,8% kanë 1-4 klasë dhe 8,8% kanë 5-8 klasë. Gjatë intervistimit është vërejtur që shkallën më të lartë të arsimimit e kanë patur personat me moshë mbi 40 vjeç.

Shumica e të intervistuarve (43,5%),


janë të papunë. (Kujtojmë që shumica e të intervistuarve janë gra). Një pjesë e konsiderueshme e tyre (25,9%) e nxjerrin jetesën nga grumbullimi dhe shitja e kanoçeve dhe sendeve të tjera të mbledhura në vendgrumbullimet e plehrave. 15,9 % janë të vetpunësuar, kryesisht me shitjen e rrobave të përdorura. 12,9% lypin në rrugë, të shoqëruara nga fëmijët e tyre.

4.2 Analiza e të dhënave

Numri i fëmijëve të regjistruar nga TLAS në çdo familje		
1 fëmijë	115	67,6%
2 fëmijë	46	27,1%
3 fëmijë	6	3,5%
mbi 3 fëmijë	3	1,8%
Gjithsej	170	100.0



Moshë e fëmijëve në kohën e regjistrimit		
1 - 6 vjeç	110	64,7%
6 - 12 vjeç	42	24,7%
12 - 18 vjeç	16	9,4%
Mbi 18 vjeç	2	1,2%
Gjithsej	170	100.0



Ndër fëmijët e regjistruar nga TLAS në çdo familje, 67,6% kanë regjistruar vetëm 1 fëmijë. Por nuk kanë qënë të pakta rastet kur familjet kanë regjistruar 2 fëmijë (27,1%). Ka patur raste edhe me 3 fëmijë dhe mbi 3 fëmijë.


Moshë e fëmijëve në kohën e regjistrimit është kryesisht e moshës parashkollore. Fillimi i shkollës, në shumë raste shërben si nxitje për familjet që të fillojnë të interesohen për regjistrimin e fëmijëve të tyre. Fëmijët e regjistruar në moshën 1-6 vjeç përbëjnë

64,7%. 24,7% janë të moshës 6-12 vjeç dhe 9,4% janë të moshës 12-18 vjeç. Ka patur raste kur të paregjistruarit kanë qënë madhorë (1,2%). Këto janë rastet e konstatuara nga TLAS, kur janë të paregjistruara vetë nënat e fëmijëve të paregjistruar.

Vëzhgimi synon të identifikojë shkaqet përse prindërit e fëmijëve kanë lejuar dhe krijuar këtë situatë të mosregjistrimit të fëmijëve të tyre.


Më poshtë po japim rezultatet e pjesës së dytë të pyetësorit.

Shkaku i mosregjistrimit të fëmijës	Frekuenca	Përqindja
Nuk kisha dijeni për afatet ligjore	76	44,7%
Nuk kisha bërë transferimin e residencës	40	23,5%
Fëmija lindi në shtëpi dhe duhej bërë gjyqi	19	11,2%
Fëmija lindi në emigracion dhe nuk kemi dokumentat	13	7,6%
Më kishte humbur certifikata e maternitetit	10	5,9%
Nuk e dinim se bëhej regjistrimi para martesës	7	4,1%
Babai i fëmijës në emigracion dhe unë di ku të shkoj	5	2,9%
Gjithsej	170	100.0




Si duket edhe nga diagrama, detyrimi i prindit sidomos i nënës, për të regjistruar lindjen e fëmijës diktohet nga disa faktore që kanë për bazë: mungesën e informacionit nga institucionet shëndetit dhe nga gjendja civile, indiferentizmin dhe mosvlerësimin e pasojës së tij, nivelin e ulët kulturor përfshirë analfabetizmin në një pjesë të konsiderueshme, kushtet ekstreme të varfërisë që shpesh shoqërohen me humbjen dhe mosruajtjen e dokumentave origjinale të institucionit shëndetësor, mungesën e kulturës për respektimin e detyrimeve ligjore në fuqi, konservatorizmin që ende ekziston në familjen shqiptare për faktin që fëmija nuk mund të regjistrohet para celebrimit ose pa qënë babai present, dhe faktorë të tjerë.

Numri i fëmijëve që ndjek shkollën ose kopështin		
Nuk e ndjek asnjë fëmijë	98	57,6%
Disa fëmijë e ndjekin, disa jo	51	30%
E ndjekin të gjithë	21	12,4%
Gjithsej	170	100.0




Shkaku i mosfrekuentimit të shkollës		
Nuk mban dot higjenën dhe nuk ka veshje të përshtatëshme	83	48,8%
Fëmija duhet të ndihmojë familjen ekonomikisht	49	28,8%
I thonë nga drejtorja, nuk të takon në këtë shkollë	12	7,1%
Diskriminohet nga nxënësit e tjerë	12	7,1%
Diskriminohet nga mësuesit	8	4,7%
Nuk ka certifikatë personale të gjëndjes civile	6	3,5%
Gjithsej	170	100,0




Shkaqet e mësipërme edhe pse në një numër të kufizuar të intervistuarish flasin për faktorë objektiv, pa rregullimin e të cilëve është e vështirë ose e pamundur të përmirësohet situata aktuale. Konkluzioni kryesor ka të bëjë me reduktimin e varfërisë dhe sigurimin e strehimit të familjeve vulnerabël. Strehimi është vendi ku fëmija do të sigurojë kushtet për të mbajtur higjenën, për t'u ushqyer normalisht dhe për të patur një vend ku mund të përgatisë detyrat shtëpijake e të studiojë si gjithë fëmijët e tjerë. Kështu vet prindërit do të jenë në gjëndje të luftojnë edhe me shfaqjet e diskriminimit nga mësuesit apo nxënësit e tjerë.


Çfarë duhet të ndryshonte për të lehtësuar regjistrimin e fëmijës		
Të mos kishte afat regjistrimi	108	63,5%
Të mos kishte gjobë apo gjoba të ishte më e vogël	35	20,6%
Të kishte njoftime për afatet ligjore në media	10	5,9%
Të kishte njoftime për afatet ligjore në zyrat e pusht. vend.	9	5,3%
Të kishte njoftime për afatet ligjore në instituc. shëndetësore	5	2,9%
Të kishte njoft. në pikat e kalimit kufitar, amb. konsullatat	3	1,8%
Gjithsej	170	100,0




I vizitoni rregullisht tek mjeku fëmijët kur sëmurën?		
Po	73	57,1%
Jo	97	42,9%
Gjithsej	170	100,0




Arsyet e mosvizitës tek mjeku		
Nuk kam certifikatë lindje të fëmijës		
Nuk kam bërë transferimin e rezidencës	31	32%
Më vjen zor ta çoj tek mjeku, se nuk e mbaj dot të pastër	8	8,2%
Gjithsej	170	



A kanë përfituar fëmijet e paregjistruar ilace falas ne vitin e pare te jetes?		
Po	161	94,7%
Jo	9	5,3%
Gjithsej	170	100,0



Arsyet e mospërfitimit të ilaçeve falas		
Nuk kam certifikatë lindje të fëmijës	86	73,5%
Nuk kam bërë transferimin e rezidencës	31	26,5%
Gjithsej	170	100,0



Në pjesën e dytë të pyetsorit trajtohen probleme të lidhura me regjistrimin lindjes së fëmijëve, pasojat dhe mendime për ndryshime në të ardhmen.

Si shkak të parë të mosregjistrimit të lindjeve brënda afatit ligjor është mosnjohja e ekzistencës së këtij afati (44,7%), mbas të cilit lindja e fëmijës duhet faktuar në gjykatë dhe duhet paguar një gjobë prej 2.000 lekë të reja.

Një problem tjetër i rëndësishëm që influencon këtë dukuri është se në kohën kur duhet bërë raportimi i lindjes së fëmijës, familja nuk jeton pranë zyrës së gjëndjes civile ku është regjistruar nëna e fëmijës, por në një vendbanim tjetër, që shumë herë është

larg nga i pari dhe kërkon shpenzime transporti dhe kohe për të shkuar deri atje. Pra mosbërja e transferimit të dokumentave të gjëndjes civile ka sjellë 23,5% të fëmijëve të paregjistruar.

I konsiderueshëm (11,2%) është edhe numri i fëmijëve që nuk kanë lindur në institucione shtetërore. Në këto raste është detyrim ligjor që regjistrimi të bëhet nëpërmjet gjykatës dhe pranisë së dëshmitarëve.

Problematike janë edhe rastet e fëmijëve të lindur jashtë shtetit, kryesisht në Greqi dhe Kosovë. Në këto raste familjarët e fëmijës nuk i kanë dokumentat e plota që kërkojnë nga zyra e gjëndjes civile, siç është çertifikata e lindjes e lëshuar nga zyra e gjëndjes civile e shtetit përkatës dhe legalizimi i kësaj çertifikate në zyrat konsullore shqiptare.

Po kështu, ndër arsyet e paraqitura janë humbja e çertifikatës së asistencës në lindje të maternitetit (5,9%), pritja për të bërë përpara martesën (4,1%) apo mungesa e babait të fëmijës, pa të cilin gruaja nuk dinte se çfarë të bënte (2,9%).

Në problem i rëndësishëm që donim të vëzhgonim, ishte edhe ndjekja nga fëmijët e shkollës apo kopshtit. Më i madh ishte numri i familjeve, fëmijët e të cilëve nuk i ndiqnin fare këto institucione (57,6%), 30% e përbënin familjet ku fëmijët i ndiqnin ato pjesërisht, ndërsa 12,4% e familjarëve u

shprehën se të gjithë fëmijët e tyre ndiqnin kryesisht shkollën dhe shumë pak fëmijë shkonin në kopsht.

Shkaku kryesor që u dha për mosndjekjen e shkollës ishte pamundësia e fëmijës për t'u paraqitur në shkollë me higjienën dhe veshjen e përshtatshme (48,8%). 28,8% e të intervistuarve u shprehën që fëmijët nuk mund të shkonin në shkollë, se ndihmonin prindërit në punët e tyre. Vërehet se është ulur ndjeshëm, në 3,5% mosregjistrimi i fëmijës për shkak të mungesës së çertifikatës së lindjes. Kjo, si rezultat i nje Urdhri të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për të regjistruar në shkolla të gjithë fëmijët nga minoriteti rom, edhe ne mungesë të çertifikatës së lindjes. 18,9% e të intervistuarve u shprehën për mosndjekjen e shkollës si rezultat i diskriminimit nga drejtoritë e shkollave, nxënësit apo mësuesit.

Ndër propozimet e bëra nga të intervistuarit për ndryshime që do të lehtësojnë regjistrimin e fëmijëve, mbizotëron kërkesa për të mos patur afat regjistrimi, 63,5%. 20,6% mendojnë që gjoba duhet të hiqet apo të zvogëlohet ndjeshëm. Pjesa tjetër, përkatësisht 5,9%, 5,3%, 2,9% dhe 1,8% kërkojnë shpalljen e njoftimeve për afatet e regjistrimit në vende të caktuara publike.

Një pjesë e intervistës i kushtohet marrëdhënies së familjeve me sistemin shëndetsor. 42,9% e fëmijëve nuk çohen për t'u vizituar

rregullisht tek mjeku, kur sëmuren. Shkaku kryesor, sipas 59,8% e të intervistuarve, është mungesa e certifikatës së lindjes, e ndjekur nga 32% që nuk kanë bërë transferimin e rezidencës. Po kështu, 94,7% e fëmijëve të paregjistruar nuk marrin ilaçe falas gjatë vitit të parë të jetës. Vërehet se sistemi shëndetësor, në dallim nga ai arsimor, nuk ka treguar ndjeshmërinë e duhur ndaj fëmijëve të minoritetit rom, për t'u siguruar edhe këtyre fëmijëve, të njëjtat të drejta si edhe fëmijëve të tjerë, pavarësisht nga fakti nëse ata janë të regjistruar, apo jo. Për marrjen e ilaçeve falas duhet të mjaftonte certifikata e asistencës së lindjes së lëshuar nga materniteti.

Për të mbledhur të dhënat është përdorur një pyetsor i krijuar apostafat për këtë vëzhgim. (shih Aneksin 1). Pyetsori përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë ka të bëjë me të dhënat social demografike, si gjinia, etnia, niveli arsimor, etj, kurse pjesa e dytë ka të bëjë me problemin kryesor që po analizohet, regjistrimi i lindjeve të fëmijëve.

Pyetsori është përdorur në intervistat direkte. Koha e intervistimit ka zgjatur afërsisht 25-30 min. Intervistimi është realizuar nga grupi i studentëve të Fakultetit të Drejtësisë, që punojnë me një projekt të posaçëm praën TLAS. Gjatë trajnimit të studentëve u trajtuan edhe çështje etike

që duheshin marrë parasysh gjatë procesit të intervistimit. Procesi i grumbullimit të të dhënave është shtrirë në periudhën maj – dhjetor 2007.

Për regjistrimin e të dhënave është krijuar një database, mbi të cilën është bërë edhe përpunimi i tyre statistikor.

Etika e procesit

Intervistuesit u trajnuan që gjatë intervistës, të sqaronin personat e intervistuar për qëllimin e intervistës dhe të merrnin pëlqimin e tyre për dhënien e mendimeve personale dhe nuk duhet t'u impononin atyre përgjigjet.

PËRFUNDIME

1. Nevoja "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8950 DATË 10.10.2002 "PËR GJENDJEN CIVILE", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 9029, DATË 13.03.2003 DHE LIGJIN NR. 9229, DATË 29.04.2004 " wshtw urgjente sepse:

1.1 Dukuria e mosregjistrimit të lindjeve të fëmijëve është shumë e përhapur në minoritetin Rome dhe në familjet e shpërngulura në Tiranë, gjatë 15 viteve të fundit. Në rastin e minoritetit Rome, si shkak kryesor i mosregjistrimit në afat, është kryesisht

mosnjohja e afateve kohore ligjore të raportimit të lindjeve. Në rastin e të shpërngulurve, si shkak kryesor i mosregjistrimit në afat është fakti se, duke qënë se këto familje vazhdojnë të jenë të regjistruara në zyrat e gjëndjes civile të vëndbanimeve të mëparshme, prindërve u duhet të shkojnë pikërisht në ato zyra për të bërë raportimin e lindjeve. Kjo gjë kërkon shpenzime udhëtimi dhe harxhim kohe. Pra, në shumicën e rasteve, mosregjistrimi në këtë pjesë të popullsisë, ka ardhur si rezultat i mostransferimit të dokumentave të gjëndjes civile në zyrat e gjëndjes civile të vëndbanimit të ri.

1.2 Përmasat e kësaj dukurie janë shumë shqetësuese. Gjatë periudhes 2003-2007, Sherbimi Ligjor Falas, TLAS, ka realizuar 1425 proçese gjyqësore për konfirmimin e lindjes së fëmijëve. Në shkallë vendi numri i fëmijëve ende të paregjistruar është i madh. Pra kjo është një dukuri me përmasa të konsiderueshme, të cilës duhet t'i jepet një zgjidhje përfundimtare.

1.3 Kërkesat e ligjit ekzistues të gjëndjes civile përbëjnë një pengesë të pakapërcyeshme për familjet e shtresave të varfra dhe të paarsimuara, për regjistrimin e fëmijëve të tyre. Mosregjistrimi i këtyre fëmijëve është me pasoja shumë të rënda.

Këta fëmijë nuk mund të kenë asnjë lloj mundësie për akses në jetën normale, në mungesë të një dokumenti identifikimi (çertifikate). Si rrjedhim, nuk mund të regjistrohen në shkollë, nuk mund të futen në punë, nuk mund të përfitojnë asnjë lloj shërbimi, nuk mund të votojnë, pra atyre iu cënohet çdo lloj e drejte njerëzore.

1.4 Nënata e fëmijëve të paregjistruar në gjëndjen civile nuk konsiderohen nëna-kryefamiljare se ato ende figurojnë beqare. Kjo do të thotë ato nuk përfikojnë të drejtën për përkrahje sociale në bazë të legjisllacionit në fuqi.

1.5 Fëmijët apo nënat e fëmijëve pa identitet, duke qënë pa dokumenta, janë kontigjenti më i favorshëm t'u përdoruar nga trafikantët për t'u trafikuar, shfrytëzuar, për falsifikuar dhe akte të tjera kriminale.

1.6 E vetmja mënyrë për të çmontuar këtë dukuri anormale në një shtet që pretendon të arrijë standartet evropiane, është përmirësimi i ligjit aktual të gjëndjes civile. Amendamenti i propozuar nga TLAS me mbështetjen e UNICEF synon korregjimin e ligjit ekzistues në disa aspekte:

a. Heqjen e mekanizmit gjyqësor të konfirmimit të lindjes dhe zëvendësimin e tij

me verifikimin administrativ;

b. Krijimin e mundësisë së regjistrimit të lindjeve dhe vdekjeve jo vetëm në zyrën e gjëndjes civile ku është regjistruar familja, por edhe në zyrën e gjëndjes civile ku ka ndodhur lindja apo vdekja.

1.7 Filtri i gjykatës nuk është mekanizmi i vetëm ligjor që duhet të vërtetojë faktin e lindjes, ka edhe mekanizma të tjerë të cilët janë po aq të sigurtë sa edhe konfirmimi gjyqësor dhe me një avantazh më të madh praktik sesa ai gjyqësor. Pikërisht ky mekanizëm alternative argumentohet në projektamendamentin e financuar nga UNICEF

1.8 Miratimi i amendamentit dhe që krijon institucionalizimin e një marrdhënieje të re ndërmjet Shërbimit të Gjëndjes Civile dhe institucionit të lindjes së fëmijës, me afate kohore të përcaktuara.

1.6 Krijimi i mundësisë së raportimit të lindjes, jo vetëm në zyrën e gjëndjes civile ku është regjistruar familja, por edhe në zyrën e gjëndjes civile ku ka ndodhur lindja do të lehtësoj procesin e regjistrimit të lindjeve, duke krijuar kushte të përshtatshme për familjet që nuk e kanë realizuar ende transferimin e dokumentave të gjëndjes civile, në momentin kur ju lind një fëmijë.

1.7 Amendamenti ofron ndihmë direkte për raportimin e vdekjeve të personave, në rastet kur ajo ndodh jashtë zonës që mbulon zyra e gjëndjes civile ku është regjistruar personi. Familjet mund të regjistrojnë vdekjen e pjestarëve edhe në zyrat e gjëndjes civile ku ka ndodhur vdekja. Ligji sot lejon regjistrimin e martesave në çdo zyrë të gjëndjes civile, aq më shumë duhet të lejojë në mënyrë analoge edhe raportimin e lindjeve dhe vdekjeve, më regjistrimi i të cilave është me pasoja jo vetëm për qytetarët, por edhe për shtetin.

1.8 Miratimi i këtij projektligji, që nuk shoqërohet me asnjë kosto financiare, përbën mjetin ligjor më efikas në reduktimin e ndjeshëm të fenomenit të mosregjistrimit të lindjeve të fëmijëve dhe të vdekjeve, ndihmon në pasqyrimin real të popullsisë në regjistrat e gjëndjes civile, parapërgatit Shërbimin e Gjëndjes Civile për të shkuar drejt kompjuterizimit.

2. Ka lindur nevoja emergjente e rishikimit nga njësitë vendore, të listave të dhënies së ndihmës ekonomike në favor të familjeve vulnerable. Familjet Rome duhen trajtuar në mënyrë të vecantë, sepse faktet gjithmonë e më shumë po flasin për mospërfshirjen e tyre në skemën e ndihmës

ekonomike. Një vendim i vecantë i Qeverisë kushtuar specifikës së familjeve Rome, do të mënjanonte pengesat proceduriale që përjashtojnë këtë kategori nga përfitimi i drejtës së ndihmës ekonomike.

3. Strehimi i Familjeve Rome duhet të konsiderohet nga Qeveria Shqiptare si kusht parësor për integrimin e komunitetit Romë në shoqërinë Shqiptare. Nuk mund të flitet për përfshirje të fëmijëve dhe të rinjëve Rome në shoqëri, në procesin e edukimit, në shërbimin shëndetësor në skemën e punësimit formal, etj pa i siguruar këtij komuniteti një strehëz ku mund të flejë, të lahet të ushqehet normalisht si qenie njerëzore. Ka ardhur momenti që Qeveria Shqiptare të zbatojë një project afatgjatë dhe konkret për strehimin normal të komunitetit Rome.

4. Ministria e Shëndetësisë, gjithashtu duhet të kujdeset dhe trajtojë me një urdhëresë të posacme përparësinë për akses të pacientëve nga komuniteti Rome në shërbimet parësore dhe ato spitalore. Vecanërisht institucionet e kujdesit për nënat shtatzane dhe të porsalindurit duhet të trajtojnë me përparësi nevojat e komunitetit Rome.

PYETSOR PËR RAPORTIN E VLERËSIMIT

1. Vendbanimi:
 - Tiranë ☐
 - Rrethi Tiranë ☐
 - Rreth tjetër, specifiko: ☐
2. Përkatësia në komunitet etnik:
 - Rom ☐
 - Egjyptian ☐
 - Tjetër ☐
3. Gjinia:
 - Femër ☐
 - Mashkull ☐
4. Gjëndja civile:
 - I/E martuar ☐
 - Beqar/e ☐
 - I/E shkurorëzuar ☐
 - I/E ve ☐
5. Numri i personave në familje:
 - 1 ☐
 - 2 ☐
 - 3 ☐
 - 4 ☐
 - 5 ☐
 - mbi 5 ☐
6. Numri i fëmijëve në familje:
 - 1 ☐
 - 2 ☐

- | | | | |
|---------|--------------------------|-----|--------------------------|
| • 3 | ☐ | • 1 | ☐ |
| • 4 | ☐ | • 2 | ☐ |
| • 5 | ☐ | • 3 | ☐ |
| • mbi 5 | ☐ | • 4 | ☐ |
-
- | | | | |
|----------------|--------------------------|---|--------------------------|
| 7. Moshë: | | 12. Cili është shkaku i mosregjistrimit të fëmijës në afatin ligjor: | |
| • 18 – 29 vjeç | ☐ | • Nuk kisha dijeni për afatet ligjore të raportimit të lindjes; | ☐ |
| • 30 – 39 vjeç | ☐ | • Ka qënë babai i fëmijës në emigracion dhe unë nuk bëj asgjë pa të; | ☐ |
| • 40 – 49 vjeç | ☐ | • Mendonim se nuk bëhej regjistrimi i lindjes përpara martesës; | ☐ |
| • 50 – 59 vjeç | ☐ | • Nuk kemi marrë dokumentat e nevojshme për regjistrim nga emigracioni; | ☐ |
| • mbi 60 vjeç | ☐ | • Kur lindi fëmija nuk kishim bërë transferimin e residencës; | ☐ |
-
- | | | | |
|----------------|--------------------------|--|--------------------------|
| 8. Arsimi: | | • Na kishin humbur dokumentat e maternitetit; | ☐ |
| • Analfabet | ☐ | • Fëmija lindi në shtëpi dhe nuk kishim dokumentacionin e duhur. | ☐ |
| • 1 – 4 klasë | ☐ | | |
| • 5 – 8 klasë | ☐ | | |
| • 9 – 12 klasë | ☐ | | |
| • mbi 12 klasë | ☐ | | |
-
- | | | | |
|--------------------|--------------------------|--|--------------------------|
| 9. Punësimi: | | 13. Cili është shkaku i mosfrekuentimit të shkollës nga ana e fëmijës: | |
| • I punësuar | ☐ | • Nuk ka çertifikatë lindje; | ☐ |
| • Lyp | ☐ | • Nuk mban dot higjienën dhe nuk ka veshje të përshtatëshme; | ☐ |
| • I papunë | ☐ | • Duhet të ndihmojë familjen ekonomikisht; | ☐ |
| • I vetëpunësuar | ☐ | • Diskriminohet nga nxënësit e tjerë; | ☐ |
| • Kërkon në plehra | ☐ | • Diskriminohet nga mësuesit; | ☐ |
-
- | | | | |
|---|--------------------------|--|--|
| 10. Sa fëmijë keni regjistruar nëpërmjet Shërbimit Ligjor Falas Tiranë: | | | |
| • 1 | ☐ | | |
| • 2 | ☐ | | |
| • 3 | ☐ | | |
| • mbi 3 | ☐ | | |
-
- | | | | |
|--|--|--|--|
| 11. Sa fëmijë të moshës shkollore në familje nuk shkojnë në shkollë: | | | |
|--|--|--|--|

- Nuk e pranojnë të regjistrohet se i thonë që nuk i takon në këtë shkollë. ☐
- 14. Mosha e fëmijëve të regjistruar nga TLAS (në kohën e regjistrimit):
 - 1 – 5 vjeç ☐
 - 5 – 10 vjeç ☐
 - 10 – 18 vjeç ☐
 - mbi 18 vjeç ☐
- 15. Çfarë do të donit të ndryshonte që të lehtësohej regjistrimi i fëmijëve:
 - Të mos kishte afat regjistrimi; ☐
 - Të mos kishte gjobë, apo gjoba të ishte më e vogël; ☐
 - Të kishte njoftime për afatet ligjore në zyrat e pushtetit vendor; ☐
 - Të kishte njoftime për afatet ligjore në institucionet shëndetësore; ☐
 - Të kishte njoftime për afatet ligjore në pikat e kalimit kufitar, amb./konsullatat; ☐
 - Të kishte njoftime për afatet ligjore në media (radio, TV). ☐
- 16. I vizitoni tek mjeku fëmijët kur sëmuren?

Po ☐ Jo ☐
- 17. Nëse Jo, cila është arsyeja që nuk i vizitoni ?
 - Nuk kam certifikatë të fëmijës; ☐
 - Nuk kam bërë transferimin e residencës; ☐
- Nuk e mbaj dot pastër fëmijën. ☐
- 18. A kanë përfituar fëmijët ilaçe falas gjatë vitit të parë të jetës dhe vaksinim?

Po ☐ Jo ☐
- 19. Nëse Jo, cilat janë arsyet?
 - Nuk kam certifikatë të fëmijës; ☐
 - Nuk kam bërë transferimin e residencës. ☐



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

TLAS

